



2372

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES  
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT  
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

## PROJEKT V E N D I M

Nr. 16, datë 15.04.2022

“Për ndryshimin e vendimit nr 19 datë 28.03. 2022 për ndryshim afati të marrjes me qira nga 9 (nëntë) vjecar në 10 vjecar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, në ngastrat nr.6 dhe 17 në ekonominë pyjore Karmë.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” ,i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_2022 të Këshillit të Bashkisë të:

## V E N D O S I

1.Ndryshimin e vendimit nr 19 datë 28.03. 2022 për dhënie në përdorim të sipërfaqes në total 4.4 ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” në ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonominë pyjore Karmë.

, sipas listës së inventarit, shtojca nr.47 në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

2.Afati i dhënies me qira të jetë 10 (dhjetë) vjet.

3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Konceptoi: Z. Ujka 

Konceptoi Bazën Ligjore K. Shtatri 

Miratoi: Rr. Ftoni 

KRYETARI  
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 27 prot.

Vau Dejës, më 15.04, 2022

**RELACION**

**Për ndryshim vendimi nr 19 datë 28.03.2022.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kulloror në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kulloror publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika el neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik” pika 7.

**Për arsye të procedurës se metejshme të lejës se ndertimit i propozojme keshillit bashkiak ndryshimin e afatit të perdorimit të vendimit nr 19 datë 28.03.2022 nga 9-të (nentë) vjekar në 10-të (dhjetë) vjekar duke mos ndryshuar sipërfaqen ,vlerën dhe funksionin .**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e vendimit.

**Specialistet**

**Ing.Mark Suli**

**Ing.Zeqir Ujka**

**Miratoi**

**Drejtori**

**Rrok Ftoni**